

Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të nenit 31 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e RMV nr.14/2022), duke vepruar sipas Rekomandimit të Byrosë për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me aktgjykimin e GJEDNJ të 21 marsit 2023 në lëndën *Radika transporte SHPK Lubjana kundër Maqedonisë së Veriut*, A. nr.52003/18, në seancën e mbajtur më 09.10.2023, nxori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Gjatë vendimmarrjes mbi kërkesëpadinë për kompensimin e dëmit që buron nga marrja e mjeteve në procedurë penale respektivisht për kundërvajtje, sidomos në kushte kur procedura nuk ka përfunduar me përcaktimin e përgjegjësisë penale respektivisht për kundërvajtje, pavarësisht nga cila arsye, gjykata do të zbatojë testin trepalësh të formuar në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që do të thotë se për tu konstatuar ajo se në rastin konkret masa ka qenë ligjore, vallë e njëjta ka pasur qëllim legjitim, si dhe vallë e njëjta ka qenë proporcionale, që duhet të jetë e sqaruar edhe në mënyrë adekuate.

Principi i proporcionalitetit të masës kontestuese – marrja e përkohshme e mjeteve nënkupton se gjykata është e obliguar që të shqyrtojë mendimin dhe konstatimin ekspert të përgatitur në lidhje me lartësinë e dëmit të kërkuar përkatësisht fitimit të humbur, të dorëzuar nga ana e paditësit, që të përcaktohet se vallë me marrjen e përkohshme nuk shkaktohet dëm shumë i madh nga ajo e pashmangshmja, si dhe të sigurohet ekuilibri midis interesave të prekur, dhe sipas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut *Radika transporte SHPK Lubjana kundër Maqedonisë së Veriut*, A. nr.52003/18, të datës 21 mars 2023.

## A r s y e t i m

Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 09.10.2023 shqyrtoi mbi shkresën me Rekomandimin e Byrosë për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nr.0901-100/6 të datës 11.06.2023, mbi lëndën *Radika transporte SHPK Lubjana kundër Maqedonisë së Veriut*, A. nr.52003/18, aktgjykimi i GJEDNJ të datës 21 mars 2023, për miratimin e qëndrimit parimor ose konkluzionit të sektorit kompetent në vijën e principeve dhe qëndrimeve të GJEDNJ, të shprehura në aktgjykimin në fjalë, në të cilin potencohet principi i proporcionalitetit gjatë vendimmarrjes për kompensimin e dëmit për marrjen e përkohshme të mjeteve në procedurën penale, respektivisht për kundërvajtje nuk kanë rezultuar me përcaktimin e përgjegjësisë penale respektivisht për kundërvajtje, pavarësisht shkaqeve.

Në aktgjykimin e theksuar nga ana e Gjykatës për të Drejtat e Njeriut është konstatuar shkelja e nenit 1 të Protokollit nr.1 (e drejta e pronësisë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Objekt i aktgjykimit është procedura civile për kompensimin e dëmit, të cilën e ka iniciuar kompania aplikante. Në fakt, kompania aplikante që profesionalisht është marrë me transportin dhe që ka qenë pronare e automjetit transportues, e që është marrë përkohësisht nga policia përderisa është drejtuar nga z. F. në kuadër të procedurës doganore

për kundërvajtje në prill 2010, e më vonë përkatësisht në shtator 2012 e njëjta i është kthyer kompanisë aplikante pasi që Drejtoria e Doganës ka konstatuar se mbajtja e tij nuk është më e nevojshme. Në vitin 2012 kompania aplikante ka iniciuar procedurë civile për kompensimin e dëmit, të cilën kinse e ka pasur si pasojë të automjetit të marrë përkohësisht, në emër të fitimit të humbur, duke marrë parasysh veprimtarinë me të cilën është marrë dhe faktin që automjeti që ka qenë pronë e kompanisë ka qenë i papërdorshëm në periudhën në fjalë për realizimin e veprimtarisë që ka qenë burim i të ardhurave të kompanisë aplikante. Në shtesë të kërkesëpadiës është dorëzuar edhe mendimi dhe konstatimi ekspert, ndërsa vet padia është parashtruar në bazë të nenit 141 të Ligjit për marrëdhënie obligative.

Me aktgjykimin TS-835/12 të datës 01.12.2014 të Gjykatës Themelore II Shkup, refuzohet kërkesëpadia e paditësit me arsyetim se shteti nuk mund të konsiderohet si përgjegjëse, për arsye që automjeti është marrë përkohësisht në mënyrë ligjore për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar për kundërvajtjen e bërë doganore, dhe nuk është marrë si rezultat i lëshimit ose veprimit të paligjshëm të ndonjë organi shtetëror që kanë vepruar lidhur me marrjen e automjetit. Me TSZH-444/15 të datës 30.12.2015 të Gjykatës së Apelit Shkup, është konfirmuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ndërsa nga ana e Gjykatës Supreme të RM me aktgjykimin Rev1.nr.5/2017 të datës 28.02.2018 revizioni është refuzuar.

GJEDNJ ka konstatuar se masa marrja e përkohshme e automjetit, në rrethanat e rastit ka qenë ligjore dhe ka pasur qëllim legjitim, e orientuar kah parandalimi i keqpërdorimit të sistemit doganor, por edhe shkeljen e të drejtës së pronësisë gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të masës për marrjen e përkohshme të automjetit në kontekst të procedurës civile për kompensimin e dëmit, duke marrë parasysh se kompania aplikante ka qenë pronare e automjetit, që në rrethana konkrete është kthyer në formë solide pas kalimit të dy viteve e pesë muajve.

Njëkohësisht, GJEDNJ konstaton se gjykatat e vendit kanë zbatuar shqyrtimin formal të kërkesëpadiës, duke u kufizuar vetëm në ligjshmërinë e masës kontestuese për marrjen e përkohshme të automjetit. GJEDNJ, edhe pse ka theksuar se masa ka qenë ligjore gjatë tërë kohëzgjatjes së saj, e njëjta nuk mjafton për tu përfunduar se ka qenë sipas nenit 1 të Protokollit nr.1, ngase ka mundur që të bëhet jo proporcionale, sidomos, në mungesën e shqyrtimit të aspekteve që janë të rëndësishme për rezultatin e procedurës civile.

Nga ana e GJEDNJ vërehet se të dhënat e kompanisë aplikante në procedurën për kompensimin e dëmit, në lloj të fitimit të humbur, që ka qenë e mbështetur edhe me mendimin dhe konstatimin ekspert, e duke qenë se automjeti ka qenë mjeti themelor për punën e kompanisë, të cilin ai ka qenë i penguar ta përdor për një periudhë më të gjatë prej dy viteve, përfaqëson argument që potencialisht ka pasur rolin kryesor gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të masës për marrjen e përkohshme, e që nuk ka qenë objekt i vlerësimit adekuat nga ana e gjykatave të vendit. Në këtë mënyrë tregohet se lëshimi i këtillë i gjykatave të vendit nuk është në pajtim me obligimin e gjykatave të vendit që është dashur të zbatojnë testin trepalësh (a është masa ligjore, a ka pasur qëllim legjitim dhe a ka qenë proporcionale) dhe të vlerësojnë se marrja e përkohshme e automjetit a ka shkaktuar më shumë dëme nga ajo e domosdoshmja për kompaninë aplikante.

Për shkak të së theksuarës, GJEDNJ ka arritur në përfundimin se gjykatat e vendit nuk kanë siguruar ekuilibër midis interesave të prekur (interesin pronësor të kompanisë aplikante

dhe interesin publik për parandalimin e sistemit doganor) dhe nuk kanë siguruar mbrojtjen adekuate për të drejtat pronësore të kompanisë aplikante në kontekst të procedurës civile.

Për shkak të së theksuarës, e sipas Rekomandimit të Byrosë për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Sektori i veprave civile të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nxori Konkluzionin për plotësimin e obligimit nga neni 46 nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për realizimin e aktgjykimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

**Sektori i veprave civile**